



Udhëzimi 13

Shtator 2016

Prokurimi publik

Përfshirja e vlerësimeve mjedisore në prokurimin publik

PËRMBAJTJA

- [Vlerësimet mjedisore](#)
- [Çfarë thotë Direktiva në lidhje me vlerësimet mjedisore](#)
- [Përfshirja e vlerësimeve mjedisore në prokurimin publik](#)
- [Përgatitja](#)
- [Shpallja](#)
- [Përzgjedhja](#)
- [Vlerësimi i ofertave](#)
- [Kushtet e kontratës](#)
- [Menaxhimi i kontratës](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.



Vlerësime mjedisore

Strategjia e Evropës 2020¹ parashikon tre prioritete kryesore:

- **Rritja inteligjente:** zhvillimin e një ekonomie të bazuar në dije dhe inovacion;
- **Rritja e qëndrueshme:** nxitjen e një ekonomie me shumë burimeve efikase, të gjelbër dhe më konkurruese;
- **Rritje përfshirëse:** nxitjen e një ekonomie me një normë të lartë punësimi që sjell kohezion social dhe territorial.

Objektivat kryesore për të siguruar rritje të qëndrueshme janë të fokusuara tek mjedisi: mbështetja e kalimit drejt një ekonomie të karbonit të ulët në të gjithë sektorët, promovimin e përshtatjes ndaj ndryshimit të klimës, mbrojtja e mjedisit, nxitja e efikasitetit të burimeve dhe siguria më të madhe e energjisë.

"Vlerësimi i mjedisit" nuk ka ndonjë përkufizim të caktuar. Koncepti kuptohet më lehtë me anë të shembujve:

Shembuj të vlerësimeve mjedisore:

- Minimizimi i ndikimit në mjedis i një projektit të ndërtimit – *vendimi për të ndërtuar një tunel në vend të një rruge;*
- Inkurajimin e praktikave të punës të ndjeshme ndaj mjedisit nga operatorët ekonomik – *kërkesa ndaj një operatori ekonomik që është duke ndërtuar një rrugë përmes një zonë me bukuri natyrore që të zbatojë masa të veçanta të menaxhimit mjedisor;*
- Rritja e efikasitetit energjetik të ndërtesave - *duke kërkuar nga arkitektët që të projektojnë ndërtesa që i plotësojnë standardet më të larta të efikasitetit të energjisë;*
- Reduktimi i harxhimit të burimeve natyrore - *duke kërkuar nga operatorët ekonomikë që të riciklojnë dhe të ripërdorin e produkteve;*
- Inkurajimi i zhvillimit të burimeve alternative të energjisë - *duke blerë energji të gjelbër;*
- Reduktimi i gjurmëve të karbonit - *duke blerë automjete elektrike.*

Prokurimi publik është një nga instrumentet e bazuara në treg që mund të përdoret për të arritur objektivat e Evropës 2020. Autoritetet kontraktore kanë përdorur tashmë prokurimin publik për të çuar përpara këto lloje objektivash të gjera politike.

Pyetjet kryesore nga këndvështrimi i prokurimit janë si më poshtë:

- Cilat dispozita në Direktivën e Sektorit Publik (Direktiva)² u mundësojnë autoriteteve kontraktore që të përfshijnë vlerësimet mjedisore në procesin e prokurimit?
- Nëse lejohet me ligj që të vepohet në këtë mënyrë, atëherë kur dhe si mund të bëhet kjo?

Çfarë thotë Direktiva në lidhje me vlerësimet mjedisore?

¹ [EVROPA 2020. Strategjia evropiane për rritje inteligjente, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.](#)

² Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

Direktiva sqaron se si mund të kontribuojnë autoritetet kontraktore në mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, duke siguruar që ata të mund të marrin vlerën më të mirë të parasë për kontratat e tyre.

Duhen mbajtur parasysh dy qasje:

Së pari, Direktiva përcakton detyrimin e përgjithshëm për të gjitha Shtetet Anëtare (dhe autoritetet kontraktore) që të marrin masat e duhura për të siguruar që gjatë realizimit të kontratave publike operatorët ekonomik respektojnë detyrimet në fushën e së drejtës së mjedisit. Ky detyrim synon të sigurojë integrimin e duhur të **kërkesave mjedisore** në procedurat e prokurimit publik.

Detyrimet që duhet të plotësohen janë ato që zbatohen në vendin ku punimet realizohen ose ku shërbimet ofrohen dhe që kjo rezultojnë nga ligjet, rregullat, dekretet dhe vendimet, si në nivelin kombëtar ashtu dhe në nivelin e Bashkimit Evropian (BE). Detyrimet mund të rrjedhin edhe nga marrëveshjet kolektive ose dispozitat ligjore mjedisore ndërkombëtare, me kusht që rregullat e tilla, si dhe zbatimi i tyre të jenë në përputhje me të drejtën e BE-së.³

Kontrasti i respektimit të dispozitave ligjore mjedisore mund të kryhet në të gjitha fazat përkatëse të procedurës së prokurimit: kur zbatohen parimet e përgjithshme që rregullojnë përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave, kur zbatohen kriteret përjashtimit, dhe kur zbatohen dispozitat lidhur ofertat anomalisht të ulëta.

Së dyti, Direktiva përmban një numër dispozitash të rëndësishme që kanë të bëjnë në mënyrë specifike me mënyrën se si të përfshihen vlerësimet mjedisore në procesin e prokurimit **për të promovuar objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm**:

- **Specifikimet teknike - karakteristikat mjedisore:** Specifikimet teknike mund të formulohen në lidhje me performancën ose kërkesat funksionale, të cilat mund të përfshijnë karakteristikat mjedisore. Autoritetet kontraktore mund të përdorin specifikime të detajuara, siç përcaktohet nga eko-etiketat evropiane apo shumëkombëshe ose eko-etiketat te tjera, por që i nënshtrohen vetëm i përmbushjes së kushteve të përcaktuara.
- **Kushtet e përmbushjes së kontratave – që favorizojnë zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit:** Autoritetet kontraktore mund të përcaktojnë kushtet e veçanta të mjedisit në funksion të zbatimit të kontratës, me kusht që:
 - Ato të jenë të lidhura me objektin e kontratës;
 - Ato paraqiten në thirrjen për konkurrim ose në dokumentet e prokurimit.

Me synimin për të përmirësuar integrimin e vlerësimeve mjedisore në procedurat e prokurimit, autoritetet kontraktore u lejohe të përdorin kushtet e realizimit të kontratës në lidhje me punët, furnizimet ose shërbimeve që do të ofrohen, në çdo fazë të ciklit të tyre të jetës, nga nxjerrja e lëndëve të para për produktin deri në fazën e asgjësimit të produktit. Autoritetet kontraktore mund të përdorin kushtet e realizimit të kontratës në lidhje me faktorët që janë të përfshirë në procesin e veçantë të prodhimit, ofrimit ose të prodhimit, madje edhe kur faktorë të tillë nuk janë pjesë e lëndës materiale të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të blera.

Për shembull, autoritetet kontraktore mund të vendosin kushte që kanë të bëjnë me çështjet e mjedisit të tilla si:

³ Aneksi X i Direktivës përmban një listë të konventave ndërkombëtare mjedisore: Konventën e Vjenës për mbrojtjen e Shtresës së Ozonit dhe Protokolli i saj i Montrealit për substancat që hollojnë shtresën e ozonit, Konventën e Bazelit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimit të tyre (Konventa e Bazelit), Konventën e Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (Konventa e Stokholmit për POP-të), Konventën mbi procedurën e pëlqimit paraprak të argumentuar për disa kimikate dhe pesticide të rrezikshme në tregtinë ndërkombëtare (UNEP/FAO) (Konventa PIC) Roterdamit, 10 shtator 1998 dhe tre Protokollet e saj rajonale.

- Prodhimi i produkteve të blera nuk do të përfshijë kimikatet toksike;
- Shërbimet e blera duhet të sigurohen duke përdorur makina efikase për sa i takon energjisë;
- Ambalazhimi i produkteve të blera bëhet duke përdorur materiale të riciklueshme.

Megjithatë, autoriteteve kontraktore nuk u lejohet që t'u kërkojnë ofertuesve që ata të kenë një politikë të përgjegjësi korporative mjedisore.

Për më tepër, operatorët ekonomikë që pranojnë kushtet nuk mund të përjashtohen thjesht sepse autoriteti kontraktues ka mendimin se operatori ekonomik nuk do të plotësojë kushtet.

- **Të dhënat për aftësitë teknike të operatorit ekonomik - masat e menaxhimit të mjedisit:** Në rastet e duhura (që lidhen me aftësitë teknike), autoritetet kontraktore mund të kërkojnë masat e menaxhimit mjedisor si provë e aftësive teknike të një operatori ekonomik për realizimin e kontratës së punëve publike ose të shërbimeve publike.

Ku autoritetet kontraktore kërkojnë paraqitjen e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura që vërtetojnë pajtueshmërinë e operatorit ekonomik me sistemet ose standardet e caktuara të menaxhimit mjedisor, ata i referohen Skemës së Eko-menaxhimit dhe Auditimit të BE-së ose sistemeve të tjera të njohura të administrimit mjedisor.

- **Karakteristikat mjedisore si kritere për shpalljen e fituesit:** Oferta ekonomikisht më e favorshme nga pikëpamja e autoritetit kontraktor mund të identifikohet në bazë të çmimit ose koston duke përdorur qasjen e kosto-efektivitetit të tillë si cikli i koston së jetës, dhe mund të përfshijë edhe raportin më të mirë çmim/cilësi.

Në kontekstin e raportit më të mirë çmim/cilësi, Direktiva përcakton një listë jo shteruese të kriterëve mbi të cilat autoriteti kontraktues mund të bazojnë shpalljen fituese të ofertës ekonomikisht më të favorshme. Kjo listë i referohet në mënyrë specifike "karakteristikave mjedisore". Kriteret e përdorura duhet të jenë të lidhura me objektin e kontratës dhe nuk duhet t'i japin Autoritetit Kontraktor liri zgjedhje të pakufizuar.

- Ku përdoret kostoja e ciklit të jetës, atëherë mund të merren në konsideratë koston specifike të lidhura me vlerësimet mjedisore, të tilla si:
 - Kostot e fundit të jetës (p.sh., kostot e mbledhjes dhe të riciklimit);
 - Kostot që llogaritet për eksternalitetet mjedisore të lidhura me produktet, shërbimet ose punët gjatë ciklit të tyre jetësor, me kusht që vlera monetare të mund të përcaktohet dhe verifikohet (p.sh., kostoja e emetimeve të gazrave serrë, emetimet ndotësve të tjerë dhe kosto e tjera të zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike).

Përfshirja e vlerësimeve mjedisore në prokurimin publik

Një nga sfidat e zakonshme me të cilat përballen prokuruesit publik gjatë zbatimit të vlerësimeve mjedisore është identifikimi i kriterëve mjedisore që do të përdoren, pasi prokuruesit zakonisht nuk do të kenë ekspertizë në këtë fushë.

Përgatitja

Direktiva përmban shumë pak informacion që ka të bëjë në mënyrë specifike me zhvillimin e fazës para-shpalljes. Fokusi i Direktivës përqendrohet në zhvillimin e procesit konkurrues të prokurimit.

Në parim, Direktiva nuk e pengon një autoritet kontraktor që të zbatojë vlerësimet mjedisore kur të vendosë për të bërë një blerje. Për këtë arsye, vendimet strategjike të blerjes mund të merren duke

pasur parasysh vlerësimet mjedisore, me kusht që këto rrethana të mos jenë në kundërshtim me dispozitat e Traktatit.⁴

Në praktikë, faza e përgatitjes ofron mundësi të mëdha për përfshirjen e vlerësimeve mjedisore që do të ndikojnë në të gjithë procesin e prokurimit. Arsyeja për mundësi të tilla është se në fazën e përgatitjes:

- Merren vendimet kyçe strategjike të blerjes;
- Përcaktohet objekti i kontratës;
- Hartohet njoftimi i kontratës;
- Përgatiten specifikimet e përgjithshme dhe teknike;
- Hartohen termat dhe kushtet e kontratës.

Këto elemente kanë lidhje të drejtpërdrejtë me fazat e mëvonshme të procesit, ndërkohë që edhe vendimet e marra para fillimit të prokurimit mund të kenë një ndikim të madh. Për shembull, në qoftë se specifikimet teknike janë përgatitur duke marrë parasysh kriteret përkatëse mjedisore, këto kriteret mund të pastaj të jenë pjesë e kriterëve të vlerësimit të tenderit dhe për këtë arsye të ndikojnë në vendimin përfundimtar çmimin.

Përcaktimi i objektit të kontratës dhe zgjedhja e një titulli përkatës ofron një mundësi për ta informuar tregun për objektivat e autoritetit kontraktues (p.sh., kompjutera që janë efikas për sa i takon energjisë, energjia nga burimet e rinovueshme, ndërtimi i qëndrueshëm i ndërtesave, shërbimet e qëndrueshme të pastrimit).

Shënim mbi kriteret e Prokurimit të Gjellbër Publik të BE-së (GPP):

Kriteret e GPP-së së BE-së janë hartuar për të lehtësuar përfshirjen e kërkesave të gjelbra në dokumentet e prokurimit. Kriteret e GPP-së kanë për qëllim të arrijnë një ekuilibër të mirë midis performancës mjedisore, vlerësimeve të kostos, disponueshmërisë së tregut dhe lehtësisë së verifikimit. Autoritetet kontraktore mund të zgjedhin, sipas nevojave të tyre, që të përdorin të gjitha ose vetëm disa kërkesa në procedurat e tyre.

Aktualisht janë në dispozicion kriteret e zakonshme të GPP-së për sektorët e mëposhtëm:

- letër kopjimi dhe shkrimi
- produktet dhe shërbimet e pastrimit
- pajisje të IT-së për zyrë
- ndërtimi
- transporti
- mobiliet
- elektriciteti
- shërbimet e ushqimit dhe të kateringut
- tekstilet
- Produktet dhe shërbimet e kopshtarisë

⁴ Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian - version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, *Gazeta Zyrtare të Bashkimit Evropian*, C 326, 26 tetor 2012. Në Udhëzimin e Prokurimit Traktati referohet si "TFBE" ose "Traktati"

- Pajisjet elektrike dhe elektronike që përdoren në sektorin e kujdesit shëndetësor
- Pajisjet e imazherisë
- Nyjet sanitare
- Infrastruktura e ujërave të zeza
- Ngrohësit me ujë
- Tualetet dhe banjat
- Panelet e murit
- Ngrohja dhe energjia e kombinuar
- Ndërtimi i rrugëve dhe sinjalistika
- Ndriçimi rrugor dhe semaforët
- Ndriçimi i brendshëm

Për informacion të mëtejshëm mbi kriteret e GPP-së, referojuni faqes së internetit Evropa⁵.

Konsultimi paraprak i tregut mund të ndihmojnë në identifikimin, para fillimit të prokurimit, të teknologjive apo zgjidhjeve në funksion të mundësisë së arritjes së objektivave mjedisore. Shih Udhëzimin nr. 32 të SIGMA-s për Prokurimin publik , *Analiza e tregut, konsultimet paraprake të tregut dhe përfshirja paraprake e kandidatëve/ofertuesve*.

Shënim mbi Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis:

Për lloje të caktuara të projekteve publike dhe private është e detyrueshme që të ndërmerret Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM). Ky detyrim nuk rrjedh nga direktivat e prokurimit, por nga Direktiva 2011/92/BE, "Direktiva e VNM-së".

Kur një projekt i përket llojit që i nënshtrohet Direktivës së VNM-së, autoriteti kontraktues duhet të realizojë një VNM më parë në mënyrë që autoriteti të ketë të gjithë informacionin përkatës që do t'i mundësojë atij që të marrë një vendim duke në dijeni të plotë të ndikimit në mjedis të atij vendimi.

Llojet e projektit të mbuluara janë përcaktuar në Direktivën e VNM-së dhe mund të përfshijnë, për shembull, rafineritë e naftës, stacionet e energjisë, aeroportet, objektet e depozitimit të mbeturinave, si dhe projekte të tjera të mëdha të infrastrukturës.

Zbatimi i një VNM-je mund të ketë efekt mbi objektin e kontratës dhe/ose në klauzolat e realizimit të kontratës.

Për informacion të mëtejshëm mbi Direktivën e VNM-së, shihni faqen e internetit Evropa⁶.

Shpallja

Është e rëndësishme që autoriteti kontraktues të identifikojë paraprakisht nëse vlerësimet mjedisore të përfshihen në këtë proces dhe se si të bëhet kjo përfshirje. Nëse autoriteti kontraktues dëshiron të përdorë vlerësime të tilla, atëherë ai duhet t'u referohet atyre paraprakisht në ftesën për konkurrim dhe/ose në dokumentet e prokurimit. Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë ai nuk mund të jetë në gjendje që t'i përfshijë këto konsiderata në një fazë të mëvonshme. Për shembull:

⁵ http://ec.europa.eu/environment/gpp/eu_gpp_criteria_en.htm

⁶ <http://ec.europa.eu/environment/eia/>

- Mundësia e kontratës duhet të jetë e përshkruar qartë dhe saktë. Nëse, për shembull, autoriteti kontraktues kërkon një rrugë me tunele në vend të një rruge që është hapur në kodër, kjo kërkesë duhet të përfshihet në përshkrimin e kontratës në mënyrë që kjo të jetë e qartë për operatorët ekonomikë.
- Nëse autoriteti kontraktues kërkon variante - të cilat mund të lidhen me alternativa të favorshme për mjedisin - atëherë kjo kërkesë duhet të parashikohet në ftesën për konkurrim.
- Specifikimet minimale që ofertat duhet të përmbushë duhet të tregohen në mënyrë të qartë tek specifikimet.
- Kushtet e veçanta të kontratës duhet të specifikohen në dokumentet e prokurimit.
- Nëse autoriteti kontraktues përdor çështjet mjedisore si kritere të shpalljes së fituesit, atëherë kriteret e shpalljes së fituesit duhet të specifikohen në ftesën për konkurrim ose në dokumentet e prokurimit.

Përzgjedhja

Pas publikimit të ftesës për konkurrim, autoriteti kontraktues do të marrë kërkesat nga operatorët ekonomik që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin e tenderit. Autoriteti kontraktues do të ndërmarrë një proces në të cilin vendos se me cilët operatorë ekonomik do të nënshkruajë kontratë, me kusht që ofertuesi fitues nuk është i përjashtuar në përputhje me shkaqet e përjashtimit dhe i plotëson kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti kontraktues.

Përjashtimi: Në lidhje me çështjet mjedisore, Direktiva përcakton shkaqet jo të detyrueshme mbi të cilat mund të përjashtohen operatorët ekonomik. Shkaqet jo të detyrueshme përfshijnë përjashtimin në bazë të sjelljes jo profesionale apo sjelljes së gabuar, e cila ndoshta mund të përdoret në lidhje me vlerësimet mjedisore. Në këtë kontekst, autoritetet kontraktore kanë mundësi që të përjashtojë operatorët ekonomikë që kanë treguar se janë të pabesueshëm për shkak të shkeljeve të detyrimeve mjedisore.

Përzgjedhja e ofertuesit të përshtatshëm: Direktiva përcakton një listë të plotë të kriterëve të përzgjedhjes që mund të përdoren nga autoriteti kontraktues për të përzgjedhur operatorët ekonomik. Ka disa kufizime që lidhen me shkallën në të cilën mund të përdoren kriteret e përzgjedhjes mjedisore. Direktiva dhe jurisprudenca gjyqësore konfirmojnë sa më poshtë vijon:

- Lista e kriterëve të përzgjedhjes është shteruese, d.m.th., nuk mund të zgjerohet.
- Kjo listë e kufizuar e kriterëve është e kufizuar në mënyrë të ngushtë dhe ka pak vend për interpretim apo manovrim.
- Vlerësimi vetëm në bazë të kriterëve të përzgjedhjes mund të lidhet me aftësinë e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën specifike që është objekti i prokurimit.

Ka shumë gjasa që çështjet e mjedisit të mund të përfshihen në shqyrtimin e "gjendjes ekonomike dhe financiare" të ofertuesit. Si rezultat i kësaj, në shumicën e rasteve, mënyra në të cilën çështjet e mjedisit të mund të përdoren si bazë për mos zgjedhjen e një tenderues të veçantë është ajo që nëse këto vlerësime mund të konsiderohen si vlerësime që ndikojnë në "njohuritë teknike dhe/ose aftësinë profesionale" të ofertuesit.

Lejohet që ofertuesit t'i kërkohej informacion në lidhje me rrethanat e veçanta, të tilla si informacioni mbi përvojën relevante lidhur me sa më poshtë:

- Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme në lidhje me një kontratë të depozitimit të mbetjeve;
- Projektimi i ndërtesave për një cilësi të lartë të mjedisit në funksion të një kontrate për shërbimet arkitektonike dhe të projektimit;

- Trajtimi i heqjes dhe asgjësimit të asbestit në funksion të një kontrate për prishjen e një ndërtese.

Për informacion të mëtejshëm, referojuni Udhëzimit nr. 7 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Përzgjedhja e operatorëve ekonomikë*.

Vlerësimi i ofertave

Autoriteti kontraktues vlerëson ofertat e pranuar dhe shpall kontratën fituese.

Oferta duhet të përputhet me specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktues duke përfshirë edhe kërkesat mjedisore. Nëse oferta nuk i përmbush të gjitha karakteristikat e kërkuara, ajo do të konsiderohet si e parregullt.

Rregulla specifike për etiketat: Etiketat (ose eko-etiketat) mund të përdoren në prokurimin publik, edhe si një burim i kriterëve mjedisore - për specifikimet ose për fazën e dhënies së kontratës - dhe si një formë e verifikimit.

Autoritetet kontraktore mund të kërkojnë një etiketë të veçantë si mjete dhe dëshmi që punët, shërbimet ose furnizimet korrespondojnë me karakteristikat e kërkuara, me kusht që të gjitha kushtet e mëposhtme të jenë përmbushur:

- Kërkesat e etiketave kanë të bëjnë vetëm me kriteret që janë të lidhura me objektin e kontratës dhe janë të përshtatshme për të përcaktuar karakteristikat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve që janë objekt i kontratës.
- Kërkesat e etiketave bazohen në kritere objektivisht të verifikueshme dhe jo diskriminuese.
- Etiketat krijohen në një procedurë të hapur dhe transparente, në të cilën mund të marrin pjesë të gjitha palët relevante, duke përfshirë organet qeveritare, konsumatorët, partnerët socialë, prodhuesit, shpërndarësit dhe organizatat jo-qeveritare.
- Etiketat janë të aksesueshme nga të gjitha palët e interesuara.
- Kërkesat e etiketave vendosen nga një palë e tretë ndaj së cilës operatori ekonomik që aplikon për etiketë nuk mund të ushtrojë ndonjë ndikim vendimtar.

Autoritetet kontraktore që kërkojnë një etiketë të veçantë duhet të pranojnë të gjitha etiketat që konfirmojnë se punët, furnizimet apo shërbimet përmbushin kërkesat ekuivalente të etiketave.

Kur një operator ekonomik nuk ka pasur dukshëm mundësinë e marrjes së etiketën specifike të treguar nga autoriteti kontraktues ose një etiketë ekuivalente brenda afateve kohore përkatëse për arsye që nuk lidhen drejtpërdrejt me të, atëherë autoriteti kontraktues duhet të pranojë mjete të tjera të përshtatshme të provës, të tilla si një dosje teknike nga prodhuesi ose një raport testimi nga një organ i njohur.

Kriteret e shpalljes së fituesit: Autoriteti kontraktues duhet të bazojë dhënien e një kontrate publike në ofertën ekonomikisht më të favorshme. Autoriteti kontraktues duhet të ketë vendosur, në fazën e planifikimit të prokurimit, se si do të identifikojë ofertën ekonomikisht më të favorshme. Në këtë drejtim, autoriteti kontraktues do të ketë vendosur se a do të japë apo jo kontratën në bazë të (1) vetëm të çmimit, (2) të kostos, ose (3) në bazë të raportit më të mirë çmim/cilësi. Baza për shpalljen e fituesit duhet të thuhet në ftesën për konkurrim.

Është e mundur që vlerësimet mjedisore të përfshihen në ofertat që do të jepen në bazë vetëm të

çmimit duke përfshirë kërkesat përkatëse në specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës. Meqë çmimi është kriteri i vetëm i shpalljes së fituesit, atëherë nuk ka mundësi për të përfshirë kriteret specifike që lidhen me vlerësimet mjedisore.

Ku kërkesat mjedisore përfshihen në mënyrë legjitime në specifikimet teknike, atëherë ka një lidhje të qartë me objektin e kontratës. Është gjithashtu e mundur që të përkthehen të gjitha ose disa nga specifikimet teknike në kritere të shpalljes së fituesit. Kjo ndodh kur autoriteti kontraktues propozon për të dhënë një kontratë në bazë të raportit më të mirë çmim/cilësi, duke përfituar në këtë mënyrë më shumë mundësi për të përfshirë vlerësimet mjedisore. Kriteret e tilla lejojnë një vlerësim krahasues të nivelit të performancës së ofruar nga çdo ofertë në dritën e objektit të kontratës, siç është përcaktuar në specifikimet teknike.

Direktiva siguron një listë jo shteruese dhe ilustruese të kriterëve të vlerësimit të ofertave, e cila përfshin një referencë të karakteristikave mjedisore. Autoriteti kontraktues ka diskrecion në zgjedhjen e kriterëve që do të aplikohen.

Megjithatë, ky diskrecion nuk është i pafund dhe ka disa kufizime. Të gjitha kriteret e dhënies së kontratës që lidhen me çështjet mjedisore dhe që përdoren për vlerësimin e raportit më të mirë çmim/cilësi duhet të plotësojnë katër kushte. Kriteret e përzgjedhjes duhet:

- Të kenë lidhje me objektin e kontratës;
- Të jenë specifike dhe objektivist të matshme;
- Të shpallen/njoftohen më parë;
- Të respektojnë të drejtën e BE-së dhe të jenë në përputhje me parimet themelore të trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës.

Kriteret e shpalljes së fituesit duhet të jenë të ndryshme nga kriteret e përzgjedhjes.

Vlerësimi i të gjitha kostove të shkaktuara gjatë gjithë ciklit të jetës së produktit mund të përdoret në mënyrë efektive për të promovuar vlerësimet mjedisore. Për shembull:

- **Kursimet e përdorimit të ujit dhe të energjisë** - gjatë projektimit e ndërtesave efektive në lidhje me energjinë kostot fillestare të ndërtimit mund të jenë më të larta, por kostot e ciklit të jetës janë më të ulëta se sa ato të ndërtesave të projektuar tradicionalisht për shkak të izolimit të mirë, sistemeve të qarkullimit të ajrit në vend se ajrit të kondicionuar, dhe ri-përdorimit të shiut.
- **Marrja parasysh e eksternaliteteve** – eksternalitetet janë dëmet ose përfitimet që nuk paguhen nga ndotësi ose përdoruesit në kushtet normale të tregut, por përballohen nga shoqëria si një e tërë. Kjo qasje mund të merret në konsideratë kur kostot e jashtme janë shkak i zbatimit të kontratës dhe ku kostot mbulohen në të njëjtën kohë direkt nga blerësi i produktit apo shërbimit.

Metodat që autoritetet kontraktore përdorin për vlerësimin e kostove të llogaritura të eksternaliteteve mjedisore duhet të përcaktohen paraprakisht në mënyrë objektive dhe jo diskriminuese, dhe ato duhet të jenë të aksesueshme nga të gjitha palët e interesuara.

Oferta anomalisht e ulët: Direktiva e lejon autoritetin kontraktues të refuzojë një ofertë anomalisht të ulët. Autoriteti kontraktues duhet para së gjithash të kërkojë me shkrim detajet e elementeve përbërëse të ofertës që i konsideron si të rëndësishme. Kur ofertuesi nuk mund të sigurojë një

shpjegim të mjaftueshëm, atëherë autoriteti kontraktues ka të drejtë të refuzojë ofertën.

Refuzimi është i detyrueshëm në rastet kur autoriteti kontraktues ka vendosur që çmimi anomalisht i ulët ose kostot e propozuara rezultojnë nga mosrespektimi i së drejtës së detyrueshme mjedisore të BE-së (ose i së drejtës kombëtare në përputhje me ligjet e BE-së).

Kushtet e kontratës

Kushtet e kontratës mund të përfshijnë klauzola të realizimit të kontratës, të cilat përdoren për të specifikuar se si të realizohet një kontratë.

Direktiva thekson në mënyrë specifike se autoritetet kontraktore mund të përcaktojnë kushtet e veçanta në lidhje me zbatimin e kontratës, me kusht që ato të jenë:

- Të lidhura me objektin e kontratës;
- Të tregohen në ftesën për konkurrim ose në dokumentet e prokurimit;
- Të mos jenë as drejtpërdrejt dhe as tërthorazi diskriminuese.

Kushtet që rregullojnë realizimin e një kontrate mund të përfshijnë, në mënyrë të veçantë, vlerësimet mjedisore.

Kufizimet në përdorimin e këtyre kushteve gjatë procesit të prokurimit: Kushtet e kontratës nuk duhet të maskohen si specifikime teknike, kritere të përzgjedhjes apo kritere të vlerësimit; kushdo që i është shpallu fitues i tenderit duhet të jetë në gjendje që të përmbushë kushtet që nga fillimi i kontratës.

Kushtet e kontratës duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë me qëllim që operatorët ekonomikë që konkurrojnë të jenë të vetëdijshëm për të gjitha detyrimet e kontratës dhe të jenë në gjendje që të vendosin çmimet në përputhje me rrethanat.

Provat e pajtueshmërisë me kushtet e kontratës nuk duhet të kërkohen gjatë procedurës së prokurimit. Operatorët ekonomik duhet të pranojnë kushtet në mënyrë që të shpallen fitues.

Kushtet e kontratës duhet të përdoren me kujdes dhe ato duhet të mbështeten nga kostot dhe përfitimet që rrjedhin.

Shembuj të kontratave të mundshme me kushte që përfshijnë vlerësimet mjedisore:

- Një kontratë punësh për ndërtimin e një ndërtese të re për zyra, e cila përfshin një kushte të kontratës që kërkon përdorimin e kontejnerëve të ri-përdorshëm për të transportuar materialet tek një shesh ndërtimi, si dhe përpjekjet për të reduktuar prodhimin e mbetjeve në shin e ndërtimit dhe për të rritur normat e riciklimit;
- Një kontratë pastrimi kërkon përdorimin e treguesve të dozimit për të siguruar që përdoret një sasi e përshtatshme e produktit të pastrimit si dhe kërkon që të detyrojë kontraktuesin që të riciklojnë paketimin kurdo që është e mundur;
- Një kontratë për furnizimin e letrës fotokopjuese që kërkon dorëzimin e letrës në sasi të duhura në mënyrë që ta mbajë numrin e furnizimeve në minimum, si dhe të bëjë furnizimin jashtë periudhave të pikut të trafikut për të reduktuar konsumin e karburantit nga automjetet e furnizimit.

Menaxhimi i kontratës

Një pjesë e rëndësishme e menaxhimit të kontratës është monitorimi për të siguruar se kontrata është duke u realizuar sipas marrëveshjes. Hartimi i kujdesshëm i specifikimeve dhe i kushteve të

kontratës për të përfshirë kushtet mjedisore është një humbje kohe nëse autoriteti kontraktues nuk arrin të kontrollojë nëse këto kërkesa përmbushen apo jo dhe nuk ndërmerr masa në rast se konstaton se kërkesat nuk janë duke u përmbushur.

Respektimi i detyrimeve në fuqi në fushën e së drejtës së mjedisit nga kontraktuesi si dhe nga nënkontraktorët e tij duhet të sigurohet me anë të veprimeve të duhura nga autoritetet kompetente kombëtare, të tilla si agjencitë e mbrojtjes së mjedisit, brenda fushës së përgjegjësive dhe kompetencave të tyre.

Shërbimet

Të njëjtat rregulla ligjore zbatohen në një masë të madhe sipas Direktivës së Sektorit Publik dhe Direktivës së Shërbimeve.⁷ Këto direktiva kanë shumë dispozita të ngjashme ose paralele. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka tentuar të zbatojë të njëjtin interpretim si për autoritetet kontraktore në sektorin publik ashtu edhe për subjektet kontraktore në sektorin e shërbimeve.

Dallimi kryesor ka të bëjë me rregullat mbi përjashtimin dhe përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë, kur dispozitat në Direktivën e Shërbimeve janë shumë më pak të detajuara dhe më pak normative sesa ato në Direktivën e Sektorit Publik.

Çfarë thotë Direktiva e Shërbimeve në lidhje me vlerësimet mjedisore? Direktiva e Shërbimeve përmban një numër dispozitash të cilat i referohen në mënyrë specifike përfshirjes së vlerësimeve mjedisore në procesin e prokurimit. Këto dispozita pasqyrojnë, në një masë të konsiderueshme, dispozitat në Direktivën e Sektorit Publik. Disa nga dallimet kryesore janë si më poshtë.

Përzgjedhja

Përzgjedhja e ofertuesve: Direktiva e Shërbimeve nuk ka përcaktuar një listë shteruese të kriterëve që do të përdoren për përzgjedhjen e ofertuesve. Kjo është shumë e ndryshme nga pozita në bazë të Direktivës së Sektorit Publik, e cili siguron një listë të detajuar dhe shteruese të kriterëve që mund të përdoren dhe të informacionit që mund të kërkohet.

Sipas Direktivës së Shërbimeve, subjekteve kontraktore u kërkohet që të përdorin "rregulla dhe kriterë objektive" kur zgjedhin operatorët ekonomik. Këto rregulla dhe kriterë objektive duhet të jenë të disponueshme për operatorët ekonomik të interesuar. Prandaj, subjektet kontraktore ndoshta kanë më shumë fleksibilitet për të përfshirë vlerësimet mjedisore në këtë fazë të prokurimit, me kusht që kriteret të kenë të bëjnë me objektin e kontratës dhe me aftësinë e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën të veçantë që është objekti i prokurimit. Rregullat dhe kriteret gjithashtu nuk duhet të shkelin parimet Traktatit.

Të njëjtat parime të përzgjedhjes zbatohen për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në sistemet e kualifikimit.

Shkaqet e detyrueshme të përjashtimit: Një subjekt kontraktues që është autoritet kontraktues i sektorit publik duhet të respektojë dispozitat që kërkojnë përjashtimin e detyrueshëm të operatorëve ekonomik nëse ata gjenden fajtor për vepra të caktuara, të cilat përfshijnë dënimet për pjesëmarrje në një organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, pastrim parash, aktivitetet terroriste, punën e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore. Ashtu si në Direktivën e Sektorit Publik, shkaqet e detyrueshme të përjashtimit të parashikuara në

⁷ Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

Direktivën e Shërbimeve nuk mbulojnë në mënyrë specifike çështjet mjedisore.

Nga ana tjetër, subjektet kontraktore që nuk janë autoritete kontraktore nuk janë të detyruara të përjashtojnë ofertuesit nga pjesëmarrja në procesin e prokurimit në bazë të dispozitave të sipërpërmendura.

Shkaqet jo të detyrueshme të përjashtimit: Të gjitha subjektet kontraktore mund të zgjedhin për të përjashtuar ofertuesit për shkaqe jo të detyrueshme, por ata nuk janë të detyruar për ta bërë këtë. Shkaqet jo të detyrueshme përfshijnë sjellje jo profesionale ose shkelje të rëndë, dhe subjektet kontraktore në këtë mënyrë kanë mundësinë e përjashtimit të operatorëve ekonomikë që kanë treguar se janë të pabesueshëm për shkak të shkeljeve të detyrimeve mjedisore nga ana e tyre.

Vlerësimi i ofertave

Subjekti kontraktues do të ketë vendosur, në fazën e planifikimit të prokurimit, se si do të japë kontratën mbi bazën e ofertës ekonomikisht më të favorshme. "Oferta ekonomikisht më e favorshme" përcaktohet në të njëjtën mënyrë si në Direktivën e Sektorit Publik dhe përfshin referencën ndaj aspekteve mjedisore.

Baza për shpalljen e fituesit duhet të deklarohet në ftesë për konkurrim.

Kur përdoret një sistem kualifikimi, subjektit kontraktues kërkohet që të ftojë ofertuesit me anë të një ftesë për konkurrim. Të njëjtat parime zbatohen për përdorimin e kriterëve të vlerësimit të ofertave.

Informacion i mëtejshëm

Botimet e SIGMA-s

Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik – Moduli C5

<http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

Udhëzimet e Prokurimit Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

Udhëzimi i Prokurimit Publik 7 të SIGMA-s, *Përzgjedhja e operatorëve ekonomikë*.

Komisioni Evropian

Faqja e internetit e Prokurimit të Gjellbër Publik:

http://ec.europa.eu/environment/gpp/index_en.htm